

Deklarata e Tiranës

REZOLUTË PËR LUFTËN KUNDËR FAKE NEWS

Duke ditur se:

- dezinformimi përfshin të gjitha format false, të pasakta apo konfuze të informacionit të konfiguruar, paraqitur apo promovuar për të dëmtuar qëllimisht publikun apo për përfitim,
- Dezinformimi nuk mbulon çështje që shfaqen nga krijimi dhe shpërndarja përmes internetit e përmbajtjes së paligjshme, (posaçërisht shpifje, fjalime urrejtoje, apo nxitje dhune), që janë subjekt i korrigjimeve rregullatore në bazë të legjislacionit të BE-së, apo legjislacioneve kombëtare, ose forma të tjera të qellimshme, por shtrembërime jo të rreme të fakteve, siç janë satira dhe parodia.
- ekspozimi i qytetarëve ndaj një shkalle të madhe dezinformimi, përfshirë informacionin konfuz apo plotësisht të rremë, është një sfidë e madhe për Europën dhe botën,
- dezinformacioni shkatërron besimin te institucionet dhe te media dixhitale dhe tradicionale, dhe dëmton demokracinë

tona duke penguar aftësinë e qytetarëve për të marrë vendime të informuara,

- dezinformacioni mbështet shpesh idetë dhe aktivitetet radikale dhe ekstremiste,
- dezinformacioni pengon lirinë e shprehjes, një e drejtë themelore e mishëruar nga Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian,
- liria e shprehjes përfshin respektin për lirinë e medias dhe pluralizmin, si edhe të drejtën e qytetarëve për të patur opinione dhe për të marrë dhe për të dhënë informacion dhe ide ”pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pavarësisht kufijve”,
- fushatat masive dezinformuese online po përdoren gjerësisht nga parti jo të ndershme për të mbjellë mosbesim dhe për të krijuar tensione shoqërore, me pasoja serioze potenciale për zhvillimin e kombeve, Europës dhe të të gjithë botës,
- dezinformacioni mund të ulë besimin te shkencën dhe faktet empirike,
- rritja e dezinformimit dhe rëndesa e kërcënimit kanë nxitur rritjen e ndërgjegjësimit dhe shqetësimit në shoqërinë civile

si në vendet anëtare të BE-së dhe në komunitetin ndërkombëtar,

- 83% e europianëve e konsiderojnë aktualisht fake news si një problem për demokracinë në përgjithësi, "përfundimisht" (45%) dhe "deri diku" (38%),
- dezinformimi i qëllimshëm që synon të ndikojë te politikat e zgjedhjeve dhe të migrimit ishin dy kategoritë kryesore që konsideroheshin se shkaktonin dëm për shoqërinë, sipas mendimeve të ardhura pas konsultimeve publike të kryera nga Komisioni. Këto u ndoqën nga afër nga dezinformimi në fushat e shëndetësisë, mjedisit dhe politikave,
- ndikimi i dezinformimit ndryshon nga një shoqëri në tjetrën, në varësi të niveleve të arsimit, kulturës demokratike, besimit te institucionet, përfshirjes së sistemeve zgjedhore, rolit të parasë në proceset politike dhe pabarazitë sociale dhe ekonomike,
- përhapja e dezinformimit ndodh në kontekstin e një sektori medieje që po kalon në një transformim të thellë dhe po përballlet me sfida të shumta,
- demokracia në Bashkimin Europian dhe në botë mbështetet në ekzistencën e medieve të lira dhe të pavarura;

Duke vëzhguar se:

- historikisht, agjencitë e lajmeve u krijuan duke adresuar nevojën për lajme të vërteta nga gazetatat,
- agjencitë e lajmeve kanë qenë, për pothuajse 200 vjet, burimi kryesor i lajmeve të paanshme, objektive dhe prandaj të besueshme, për format e tjera të medias,
- zhvillimet teknologjike e bëjnë të lehtë që dikush që ka një smartfon të postojë "lajme" online, duke u bërë kështu një "gazetar"
- një ortek informacioni është i tejmbushur nga mediet tradicionale dhe të reja, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë për publikun dhe gazetarët që të dallojnë lajmet e vërteta nga "lajmet e bujshme"
- biznesi i agjencive të lajmeve është i bazuar rrënjësisht në shitjen e lajmeve dhe ruajtja e besueshmërisë është aspekti më i rëndësishëm i funksionimit të një agjencie lajmesh,
- sa më shumë të largohesh nga burimi kryesor i lajmit, aq më e lehtë është të hasësh në deziformim,
- agjencitë e lajmeve po përballen me sfida kur hasin me një kontekst të ri të shoqëruar nga faktorë si besimi në rënie i

publikut te media, ulja e standardeve të medieve, më shumë vështirësi në gjetjen e gazetarëve të përkushtuar dhe, së fundmi, një rritje e madhe e numrit të fake news;

Me qëllimin për:

- uljen e ndikimit të lajmeve të rreme mbi komunitetet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare,
- bërjen më të qartë se cilat entitete janë në rrënjët e përhapjes së lajmeve të rreme,
- forcimin e biznesit të agjencive të lajmeve dhe profilin si ofrues të vërtetë të lajmeve,
- rritjen e ndërgjegjësimit të publiku për kërcënimin që lajmet e rreme paraqesin për shoqëritë tona,
- rritjen e ndërgjegjësimit në mesin e gazetarëve profesionistë të medias lidhur me ndikimin që lajmi i rremë ka në të gjithë mjedisin mediatik,
- rritjen e aftësisë së gazetarëve në identifikimin dhe shmangien e lajmeve të rreme,
- promovimin e lajmeve të vërteta, të paanshme dhe të sakta për komunitetet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare;

Pas pjesëmarrjes në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga agjencia shqiptare e lajmeve ATSH, më 3 dhe 4 dhjetor 2018, në Tiranë, pjesëmarrësit e mëposhtëm, të cilët drejtojnë agjencitë e lajmeve të vendeve të tyre, bien dakord të punojnë së bashku, bazuar mbi udhëzimet e Komisionit Europian:

- për të rritur transparencën e lajmeve në internet, duke përfshirë një ndarje të përshtatshme dhe të pajtueshme me privatësinë për të dhënat mbi sistemet që mundësojnë online qarkullimin e tyre,
- për të promovuar edukimin mediatik dhe informativ për të luftuar dezinformimin dhe për të ndihmuar përdoruesit të lundrojnë në mjedisin e medias dixhitale
- për të zhvilluar mjetet për fuqizimin e përdoruesve dhe gazetarëve për të trajtuar dezinformimin dhe për të nxitur një angazhim pozitiv me teknologjitë informative të zhvilluara në mënyrë të shpejtë,
- për të ruajtur diversitetin dhe qëndrueshmërinë e ekosistemit europian të medias,
- për të promovuar kërkime të vazhdueshme mbi ndikimin e dezinformimit në Europë dhe në botë, për të vlerësuar

masat e marra nga aktorë të ndryshëm dhe për të përshtatur në mënyrë të qendrueshme përgjigjet e nevojshme,

- për të promovuar bashkëpunimin ndërmjet agjencive të lajmeve, për verifikimin e lajmeve dhe zbulimin në kohë të lajmeve të rreme,
- për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet agjencive të lajmeve për trajnimin e stafit të tyre lidhur me procedurat anti-fake news,
- për të promovuar krijimin e strukturave të reja, të besueshme dhe të përkushtuar ndaj medieve që luftojnë dezinformimin në një nivel të lartë,
- për të organizuar vazhdimisht konferenca ndërkombëtare në vende të ndryshme në lidhje me luftën kundër lajmeve të rreme,

Agjencitë e lajmeve të përmendura më poshtë i kërkojnë të gjitha agjencive individuale të lajmeve, pa marrë parasysh se ato financohen privatisht ose nga shtetet dhe shoqatat ndërkombëtare të agjencive të lajmeve, që t'i përmbahen kësaj rezolute, duke pasur parasysh interesat më të mira të peizazhit mediatik, publikun dhe shoqëritë si një e tërë.

Nismëtarët:

ATA - Shqipëri, PAP - Poloni, CNA - Qipro, ANA-MPA -
Greqi, BTA - Bullgari, KosovaPress - Kosovë, TASR –
Sllovaki, ANADOLU - Turqi AzerTac - Azerbajxhan
AGERPRES - Rumani TANJUG - Serbi HINA - Kroaci
UKRINFORM - Ukrainë